



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës për subvencionimin e kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban, nr. 01-450/03-87845/21, të datës 17.05.2021, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE KOMPANIVE PRIVATE QË OPEROJNË ME AUTOBUSË NË LINJAT E TRANSPORTIT PUBLIK URBAN

- I. Miratohet Vendimi për formimin e komisionit për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban.
- II. Komisioni nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Agim Gashi, LDK, anëtar,
 2. Bashkim Beha, PSD, anëtar,
 3. Egzon Azemi, LVV, anëtar,
 4. Leutrim Retkoceri, PDK, anëtar,
 5. Valbona Ajeti, AAK, anëtare,
 6. Vesel Makolli, AKR, anëtar,
 7. Kreshnik Smajlaj, Grupi i pavarur, anëtar,
 8. Osman Billaca, përfaqësues i ekzekutivit, anëtar,
 9. Leonora Sadiku, përfaqësuese e Zyrës ligjore, anëtare.
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është caktimi i kriterëve për ndarjen e subvencioneve kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban, në bazë të Vendimit nr. 01-450/03-87845/21, të miratur nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 17.05.2021.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdest Kryetari i Komunës.
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/04-112288/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ëëë.prishtina-komuna.org>

